



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1330/2 prot.,

Datë 29.05.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LASER MED” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “*Karta, reagente dhe aksesore të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim*” me fond limit 29,988,290 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut.

Ankimues:

Operatori ekonomik “LASER MED” SHPK, me NUIS K12128004G, me adresë: Lagjja Mjull Bathore , Rruga e Elbasanit Nr.4, perballe TEG, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut
Rr. “Lord Bajron” Laprakë, Tiranë

Në datën 28.05.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4125 dhe nr. 1330/2024 protokoli, e operatorit ekonomik “LASER MED” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-01542-04-16-2024, me objekt: “*Karta, reagente dhe aksesore të tjerë për Lab e Imuno-hematologjisë dhe Bankat e gjakut në Tiranë, përfshirë vënien e pajisjeve në përdorim*” me fond limit 29,988,290 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Kombetare e Transfuzionit të Gjakut.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “LASER MED” SHPK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “LASER MED” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 1330 prot date 28.05.2024.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Oferta refuzohet pasi rezulton “anomalisht e ulët” bazuar ne ligjin 162/2020” Per prokurimin publik “. Ne ligjin 16/2024 date 08.02.2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 162/2020” “Per prokurimin publik”, ne nenin 27 te kesaj shtese citohet si me poshte : nenin 93 i LPP pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: 5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”. Ne kete rast kur jane te vlefshme dy ose me pak oferta ne perputhje me nenin 93 te LPP/162 dhe VKM/285 date 19.05.2021 “per rregullat e prokurimit publik i ndryshuar “ neni 82 pika 4 paragrafi i pare oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogelohet me me shume se 25%te fondit limit te perlllogaritur..”

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 29.05.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro